



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 12, 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr 28 e datës 04 qershor 2008, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 8, 14 të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019 dhe nenit 9, 17, 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26 shtator 2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 18. 07. 2019, pas shqyrtimit të propozim vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

**VENDIM**  
**PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË**  
**PALUAJTSHME TË KOMUNËS**

Neni 1

Me këtë Vendim ipen në shfrytëzim afatgjatë personave fizik dhe juridik paluajtshmeritë-pronat komunale që gjinden në Zonën kadastrale Gadime e Ulët të paraqitura në tabelën si në vijim:

Nr.	Pronar	Parcela Kadastrale	Zona Kadastrale	Kultura - klasa	Sipërfaqe m <sup>2</sup>
1	Pasuri Shtet kuvendi komunal Lipjan	P-71409028-01048-0	Gadime e Ulët	----	5801
2	Pasuri Shtet kuvendi komunal Lipjan	P-71409028-01049-6	Gadime e Ulët	Bujqësore-kullosë kl.6-të	50000
3	Pasuri Shtet kuvendi komunal Lipjan	P-71409028-01049-15	Gadime e Ulët	Bujqësore-kullosë kl.6-të	40419

Neni 2

Sipas nenit 1 të këtij Vendimi pronat komunale ipen në shfrytëzim në afat prej 16 vitesh nëpërmjet konkursit publik të përcaktuar sipas Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019.

### Neni 3

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronave komunale është shfrytëzimi i shkëmbinjeve-seperim të gurëve apo të ngjajshme, sipas standardeve të përcaktuara me dispozitat ligjore.

### Neni 4

Procedurën e konkursit publik e zbaton Komisioni Vlerësues sipas Vendimit të Kuvendit Komunal, në bazë të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019.

### Neni 5

Obligohet Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër që pas përfundimit të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës të regjistroj në librat kadastral si pronë e dhënë në shfrytëzim afatgjatë në afat prej 16 vitesh.

### Neni 6

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit-sektori pronëso-ro-juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Urbanizëm Planifikim, Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtorati për Inspektion.

### Neni 7

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

15Nr. 463 - 48346  
Lipjan, më 19. 07. 2019

**KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN**

